



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV Dukagjini
Ermal PANDURI
Drejtor
Pejë

Ankesa Nr. 2017/10 KPM vs TV Dukagjini
Ref:1708/799/KPM/am

VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2017/10 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër TV
Dukagjini (“Pala Përgjegjëse”)**

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është televizion regional me seli në Pejë. Pala Përgjegjëse është pajisur me licencë të KPM-së me datën 28 gusht 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03 i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
3. KPM me datën 6 mars 2017 ka pranuar një ankesë nga znj. Blerina Lubishtani ndaj Palës Përgjegjëse, për emisionin “Zyra e ankesave”, të transmetuar prej datës 22 deri më 24 shkurt 2017, përmes të cilës Pala Ankuese pretendon se: *“Gazetari i TV Dukagjinit Arben Ahmeti, për dy ditë radhazi, më ka përgojuar, më ka ofenduar dhe më ka njollosur mua dhe familjen time, duke më paraqitur si mësimdhënëse e cila i detyron nxënësit të shkruajnë letra dashurie duke më ulur në këtë mënyrë nivelin tim prej pedagogu dhe në bisedën me kolegun e tij të Radio Dukagjinit edhe duke më paraqitur si një femër të përdalë.”*
4. KPM ka analizuar ankesën e Palës Ankuese dhe ka bërë monitorimin e emisionit ndaj të cilit është bërë ankesa. Në bazë të raportit të monitorimit të datës 9 mars 2017, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse është lëshuar në komente dhe opinione, pa pasur informata të sakta në lidhje me çështjen e parashtruar.

5. KPM me datën 14 mars 2017, nëpërmes një shkrese e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe e ka udhëzuar që brenda tre ditësh të ofrojë një sqarim lidhur me të.
6. Pala Përgjegjëse ka dështuar që brenda afatit ligjor prej tre ditësh të përgjigjet në kërkesën e KPM-së, duke mos ofruar sqarim.
7. KPM me datën 22 mars 2017, ka pranuar nga Pala Ankuese kërkesën për demant që ia ka drejtuar Palës Përgjegjëse me të cilën ka kërkuar që t'i kërkohej falje publike po në emisionin "Zyra e ankesave".
8. KPM në bazë të të gjeturave nga Raporti i monitorimit me datën 24 mars 2017 i ka dërguar Njoftim për Shkelje Palës Përgjegjëse, duke e njoftuar për shkeljet e bëra dhe duke kërkuar t'i ofrojë Palës Ankuese të drejtën e demantit në afat prej shtatë (7) ditësh. Po ashtu, në atë Njoftim, KPM e ka udhëzuar Palën Përgjegjëse të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, në të kundërtën KPM do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
9. KPM pas kalimit të afatit ligjor prej shtatë ditësh, të dhënë në Njoftimin për shkelje, me datën 11 prill 2017, ka komunikuar me e-mail edhe një herë me Palën Përgjegjëse, duke u interesuar se a e ka përmbushur obligimin për t'ia dhënë të drejtën e demantit Palës Ankuese.
10. KPM me datën 11 prill 2017 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse me anë të së cilës kanë pretenduar se nuk kanë bërë shkelje pasi që kanë plotësuar kriteret profesionale, duke e bërë një kronikë për edicionin qendror të lajmeve ku është marrë në prononcim Pala Ankuese.

Analiza Ligjore

11. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 4 dhe paragrafi 5, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
12. Neni 6, paragrafi 4, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

"Përderisa OSHM-të janë të lirë për të shprehur opinionin e tyre, ata duhet të bëjnë dallimin e qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit. Lajmi është informacion i përbërë nga faktet dhe të dhënat, ndërsa opinionin mbart mendimet, idetë, besimet, supozimet, komentet apo gjykimet vlerësuese."

KPM pas analizimit të ankesës së Palës Ankuese dhe transkriptit të emisionit në fjalë ka gjetur se Pala Përgjegjëse është lëshuar në komente dhe opinione për dy ditë me radhë, duke supozuar e komentuar se si Pala Ankuese i ka detyruar nxënësit të shkruajnë letra dashurie për ditën e Shën Valentinit, kanë dhënë mendime se çfarë do të duhej t'u mësohej nxënësve e çfarë jo, kanë komentuar se si do të duhej t'i tërhiqej vërejta mësimdhënëses dhe kanë bërë gjykim vlerësues se si ajo ka devijuar.

13. Neni 6, paragrafi 5, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

“OSHM-të e kanë obligim profesional që menjëherë të korrigjojnë çfarëdo informacioni të publikuar që është gjetur të jetë i pasaktë dhe të pranojnë gabimin e tyre. Korrigjimet duhet të planifikohen në mënyrë të përshtatshme.”

Pas verifikimit të fakteve se mësimdhënësja nuk i ka detyruar nxënësit të shkruajnë, por ajo temë është e paraparë në lëndën mësimore të Gjuhës angleze, në ditën e tretë gazetari njofton që gjithçka është në rregull, dhe se i vjen mirë që kanë hedhur dritë mbi këto dyshime. Mirëpo, e vërteta është se gazetari sapo ka marrë telefonatë nga një dëgjues për këtë çështje, pa verifikuar asnjë fakt, ka filluar për dy ditë të komentojë e të japë opinione, duke e bërë Palën Ankuese të ndjehet, siç e ka theksuar ajo në ankesë: “e përgojuar, e ofenduar dhe e njollosur”. Pala Përgjegjëse pasi që i ka verifikuar të gjitha detajet, do të duhej ta pranonte gabimin e tij, dhe ta korrigjonte atë në mënyrë të përshtatshme duke i kërkuar falje Palës Ankuese.

14. Pala Përgjegjëse konsideron që i ka dhënë hapësirën e mjaftueshme Palës Ankuese në lajmet qendrore, me një kronikë të transmetuar ku Pala Ankuese është shprehur personalisht që e ka pasur të paraparë në planprogram njësinë mësimore për ditën e Shën Valentinit. Mirëpo, Pala Ankuese nuk është e kënaqur me atë kronikë dhe ka kërkuar që t’i transmetohet reagimi po në emisionin “Zyra e ankesave”.
15. KPM ka gjetur se edhe përkundër Njoftimit për shkelje, Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 4 dhe paragrafi 5, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, duke mos i dhënë të drejtën e demantit Palës Ankuese.
16. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk është përgjigjur në dy shkresat e KPM-së, as në kërkesën drejtuar për sqarim e as në Njoftimin për shkelje, në të cilat e ka pasur obligim të përgjigjet në afat ligjor të përcaktuar saktë.

Vendimi


17. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura **kërkon** nga Pala Përgjegjëse që në afat prej shtatë (7) ditësh të transmetojë reagimin e Palës Ankuese, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
18. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, Palën Përgjegjëse e sanksionon me **Vërejtje** për shkelje të nenit 6, paragrafi 4 dhe nenit 6, paragrafi 5, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për Ankesë

19. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa

bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

20. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017
Datë